



*E martë, 10 maj 2016*

## NJOFTIM

### ZRRE dhe ERE intensivikojnë bashkëpunimin bilateral

Përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të Kosovës dhe ata të Entit Rregullator për Energji (ERE) të Shqipërisë janë takuar të premtën me 6 maj 2016, në Tiranë, për të diskutuar forcimin e marrëdhënieve bilaterale dhe për të përcaktuar sferat kryesore ku do të fokusojnë bashkëpunimin e tyre.

Kryesuesit e ZRRE dhe ERE, Z. Enver Halimi dhe Z. Petrit Ahmeti, kanë shprehur kënaqësinë për këtë takim dhe kanë vlerësuar si të domosdoshëm intensivikimin e bashkëpunimit në mes të dy rregullatorëve, sidomos tani kur dy vendet janë përcaktuar të ndërtojnë tregun e përbashkët energjetik.

Përafrimi i legjislacionit, sidomos atij sekondar; krijimi i Tregut të përbashkët të energjisë, si dhe aderimi në institucionet ndërkombëtare janë vlerësuar si prioritet i përbashkët i këtij bashkëpunimi, të cilat siç u tha, do të arrihen përmes shkëmbimit të përvojave dhe ekspertizave të dy rregullatorëve.

Ekspertët e dy Rregullatorëve kanë prezantuar para homologëve të tyre sfidat me të cilat janë duke u përballur aktualisht dhe kanë shkëmbyer mendimet profesionale në lidhje me zgjedhjet më të përshtatshme të praktikave të rregullimit ekonomik të sektorit të energjisë.

Transpozimi i legjislacionit të BE-së, ruajtja e pavarësisë, hapja e dhe monitorimi i tregut janë identifikuar si sfidat kryesore me të cilat aktualisht janë duke u përballur dy rregullatorët prandaj është vlerësuar se bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencave do të ndihmojnë rregullatorët në arritjen e synimeve të përbashkëta.

Përfaqësuesit e dy Rregullatorëve kanë vendosur që takimi i ardhshëm të mbahet në Prishtinë ku dhe do të nënshkruhet modifikimi i Memorandumit Bilateral të Bashkëpunimit, në të cilin do të përcaktohen prioritetet dhe fushat specifike ku do të fokusohet aktiviteti i ardhshëm i Partneritetit.